

VENDIM
Nr. 374, datë 6.5.2020

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 202, DATË 5.3.2020, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT,
MIRATUAR NË BUXHETIN E VITIT 2020 PËR FINANCIMIN E RINDËRTIMIT
TË BANESAVE INDIVIDUALE”, TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 13, pika 3, 16, dhe 36, pika 1, shkronja “a”, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr.97/2019, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr.88/2019, “Për buxhetin e vitit 2020”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr. 202, datë 5.3.2020, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen këto ndryshime:

a) Pikat 1 dhe 2 ndryshohen, si më poshtë vijon:

“1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 8 606 191 662 (tetë miliardë e gjashtëqind e gjashtë milionë e njëqind e nëntëdhjetë e një mijë e gjashtëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale dhe ndërtimin e rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të këtyre banesave.

2. Fondi i përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi, t’u kalojë njësisive zbatuese, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit në masën 6 465 467 211 (gjashtë miliardë e katërqind e gjashtëdhjetë e pesë milionë e katërqind e gjashtëdhjetë e shtatë mijë e dyqind e njëmbëdhjetë) lekë pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 2 140 724 451 (dy miliardë e njëqind e dyzet milionë e shtatëqind e njëzet e katër mijë e katërqind e pesëdhjetë e një) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.”

b) Pika 2.1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

“2.1 Përdorimi i fondit, i miratuar në buxhetin e vitit 2020, do të jetë 7 633 532 035 (shtatë miliardë e gjashtëqind e tridhjetë e tre milionë e pesëqind e tridhjetë e dy mijë e tridhjetë e pesë) lekë pa TVSH, nga të cilat:

a) Fondit Shqiptar të Zhvillimit, në buxhetin e miratuar për vitin 2020, në zërin “Shpenzime kapitale me financim të brendshëm” të programit 06210 “Programe zhvillimi”, i shtohet fondi prej 5 733 483 882 (pesë miliardë e shtatëqind e tridhjetë e tre milionë e katërqind e tetëdhjetë e tre mijë e tetëqind e tetëdhjetë e dy) lekësh pa TVSH, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstruksionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

b) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 1 900 048 153 (një miliard e nëntëqind milionë e dyzet e tetë mijë e njëqind e pesëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën e transfertës së pakushtëzuar, për financimin e rindërtimit të banesave individuale, brenda dhe jashtë zonave të

reja për zhvillim, ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike si dhe çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të banesave individuale, jashtë zonave të reja për zhvillim.

2. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, Fondi Shqiptar i Zhvillimit dhe Bashkia Tiranë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama